



ProCredit Bank Shqipëri
Deklaratë e Drejtorisë Ekzekutive

Deklaratë Mjedisore

Ndërgjegjësimi mjedisor, mbrojtja e mjedisit si dhe kontributi në reduktimin e pasojave të ndryshimeve klimatike kanë qenë gjithmonë një çështje e rëndësishme për Grupin ProCredit. Si pjesë e Grupit ProCredit, ProCredit Bank Shqipëri kërkon vazhdimisht të përmirësojë performancën e saj mjedisore dhe të rrisë ndërgjegjësimin mjedisor të punonjësve të saj, klientëve, palëve të interesuara dhe publikut. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zbatimit të një sistemi gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të administrimit mjedisor që synon reduktimin e ndikimit direkt dhe indirekt mjedisor.

Ky sistem përbëhet nga tre shtylla:

- Shtylla e I-rë: Sistem i brendshëm i administrimit mjedisor
- Shtylla e II-të: Administrimi i rrezikut mjedisor në kreditim
- Shtylla e III-të: Promovimi i kredisë Eko

Sistemi i Administrimit Mjedisor është në përputhje me kërkesat e standardit ISO 14001:2015 dhe me udhëzimet e Grupit ProCredit.


Në aktivitetet tona të biznesit, ne kujdesemi që aktivitetet tona të jenë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin duke mbrojtur mjedisin dhe parandaluar ndotjen.

Për të përmirësuar vazhdimisht performancën tonë mjedisore, ne udhëhiqemi nga parimet kryesore mjedisore si më poshtë:

- Identifikimi i aspekteve dhe ndikimeve mjedisore të aktiviteteve tona të biznesit
- Zhvillimi dhe zbatimi i masave për të reduktuar ndikimin negativ në mjedis
- Përdorimi sa më eficient i burimeve
- Sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin përkatës dhe standardet ndërkombëtare
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive të stafit rreth mjedisit dhe energjisë
- Minimizimi i ndikimit mjedisor dhe social në kredidhënie
- Inkurajimi i klientëve tanë për të investuar në investime miqësore me mjedisin
- Inkurajimi i furnitorëve të Bankës si dhe klientëve të saj për të zbatuar parime të ngjashme mjedisore në aktivitetet e tyre


Ne, si Drejtoria Ekzekutive e Bankës marrim përgjegjësinë për të siguruar që politika mjedisore është kuptuar plotësisht, ndiqet dhe respektohet nga të gjithë punonjësit e ProCredit Bank Shqipëri.

Datë: 14.12.2016


Adela Leka

Drejtuuese e Drejtorisë Ekzekutive




Ardiola Hristic
Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive